



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS

Nr. 98

Datë: 03.11.2006

Kuvendi Komunal, në mbledhjen e mbajtur më datën 03.11.2006, pas shqyrtimit të propozimit nr. 60 të dt. 07.07.2006, bazuar në Nenin 2.2, Nenin 4, Nenin 11 të Rregullores 2000/45 dhe Nenin 42 të Statutit Komunal, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet Projekt –Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve nga dukuritë negative që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre.
- II. Ky vendim hyn në fuqi, në ditën e aprovimit, nga Kuvendi Komunal.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryeshefit Ekzekutiv, UNMIK-ut, Drejtorisë për Inspektorat, Drejtorisë për ASH, Drejtorisë për KRS, Zyrës për ÇGJMB dhe Arkivit.

Kryetari i Komunës
Skënder Topaj
Skënder Topaj

**KOMUNA E FUSHÉ-KOSOVÉS / OPSTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSH - KOSOVE**

Bazuar në nenin 2.2,4 dhe 11 nën (d) të Rregullores 2000/45, nenin 11 dhe 29.2 të Statutit Komunal, në Parimet e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe me qëllim të krijimit të një mbrojtjeje preventive dhe efikase të të miturve nga dukuritë negative, Kuvendit Komunal i propozojmë për shqyrtim dhe miratim:

**RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA
DUKURITË QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE
ZHVILLIMIN E TYRE**

QERSHOR 2006

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 Fëmijë konsiderohen personat (jo madhor) nën moshën 18 vjeçare.
- 1.2 Persona të mitur konsiderohen fëmijët prej moshës 14 deri 18 vjet, personat prej moshës 14 deri në 16 vjet janë të mitur të rinj, kurse prej moshës 16 deri 18 vjet janë të mitur të rritur. Ndërsa, personat mbi moshën 18 vjeçare janë persona madhor.
- 1.3 Vende publike janë hapësirat, lokalet e ndryshme hoteliere, shërbyese dhe tregtare, institucionet kulturore, objektet edukativo-arsimore, kinematë dhe lokalet e natyrës së tillë.
- 1.4 Me termin „lokale afariste” kuptojmë çdo biznes individual të personave fizik dhe çdo biznes tjetër të personit juridik që zhvillon veprimtari shërbyese afariste.
- 1.5 Dukuri negative që dëmtojnë shëndetin e të miturve konsiderohen: alkooli; duhani, narkotikët e ndryshëm, shfaqjet degjeneruese, frekuentimi i të rinjve në lokalet e ndryshme në orët e vona etj.
- 1.6 Pije alkoolike konsiderohen të gjitha ato pije të cilat në përmbajtjen e tyre kanë 0.01% të alkoolit.
- 1.7 Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë për personat nën moshën 18 vjeçare.

Neni 2 Shitja dhe shërbimi me pije alkoolike dhe duhan për fëmijë

- 2.1 Ndalohet rreptësisht shitja dhe përdorimi i të gjitha pijeve alkoolike dhe duhanit, fëmijëve, brenda objekteve edukativo-arsimore.
- 2.2 Ndalohet shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike për fëmijët nën moshën 18 vjeçare nga subjektet afariste.
- 2.3 Ndalohet shitja dhe shërbimi me duhan fëmijëve nën moshën 16 vjeçare, nga subjektet tregtare-afariste që merren me shitjen dhe shërbimin e tyre.
- 2.4 Iu ndalohet rreptësisht të miturve, nën moshën 16 vjeçare, të shesin pije alkoolike dhe duhan.
- 2.5 Të miturit nga mosha 16 deri në moshën 18 vjeçare mund të shesin pije alkoolike dhe duhan vetëm në prani dhe më pëlqim të prindërve, apo kujdestarit ligjor në objektet që posedojnë leje përkatëse.
- 2.6 Iu ndalohet rreptësisht përdorimi (konsumimi) i pijeve alkoolike dhe duhanit fëmijëve nën moshën 18 vjeçare.
- 2.7 Ndalohet rreptësisht shtytja e fëmijëve për të kërkuar lëmoshë.

Neni 3 Obligimet e subjekteve afariste dhe fëmijëve

- 3.1 Fëmijët nën moshën 16 vjeçare mund të qëndrojnë në lokalet në të cilat shërbehet alkooli, vetëm në prani të prindit ose kujdestarit ligjor.

- 3.2 Të miturit e rritur prej moshës 16 deri në 18 vjeç mund të qëndrojnë në lokalet në të cilat shërbehet alkooli deri në orën 20.00, ndërsa pas orës 20,00 vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
- 3.3 Në lokalet në të cilat luhen lojërat si: Loto, Bingo, Prognoza sportive, apo lojëra të tjera të fatit, ndalohej hyrja e fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare.
- 3.4 Organizatorët e shfaqjeve të ndryshme, programeve dhe manifestimeve publike e kulturore për të rinjtë në lokalet e mbyllura janë përgjegjës në rast se në ato lokale lejohet përdorimi i pijeve alkoolike apo duhanit nga fëmijët dhe të miturit, në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
- 3.5 Të gjitha subjektet afariste që merren me shitjen dhe përdorimin e pijeve alkoolike janë të obliguara që në hyrje apo brendi të vendosin tabelën (shenjën) për ndalimin e shitjes dhe shërbimit të pijeve alkoolike dhe duhanit për fëmijë, konform dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 4. Punësimi

- 4.1 Personat nën moshën 15 vjeçare nuk mund të punësohen.
- 4.2 Personat prej moshës 15 deri në 18 vjeçare mund të punësohen vetëm për punë të lehta, gjithnjë duke patur parasysh natyrën e punës të cilat nuk e dëmtojnë shëndetin ose zhvillimin e tij/saj dhe nuk i pengojnë ata në ndjekjen e mësimin në shkollë.
- 4.3 Fëmijët prej moshës 15 deri në moshën 18 vjeçare mund të punojnë punë të lehta, gjatë ditës me orarë të shkurtuar, deri në 4 orë punë në ditë.

Neni 5 Kinematë, Internet-kafenetë dhe shtypi

- 5.1 Kinematë apo subjektet tjera që merren me shfaqje publike të filmave janë të detyruara që për fëmijët deri në moshën 14 vjeçare t'i shfaqin ato deri në ora 18.00, prej moshës 14 deri në 16 vjeçare deri në ora 20.00, ndërsa për të miturit prej 16 deri në 18 vjeç deri në ora 22.00.
- 5.2 Pas orës 22.00 shfaqje të tilla të miturit mund t'i përcjellin vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
- 5.3 Kinematë apo subjektet tjera janë të obliguara që me rastin e shfaqjes së filmave, përmbajtja e të cilave ndikon negativisht në formimin e fëmijëve në aspektin edukativ, arsimor dhe kulturor, të njoftojnë me rastin e reklamimit të filmit si dhe në hyrje të objektit ta kenë shenjën për ndalimin e hyrjes për fëmijë dhe njëkohësisht janë të obliguar që mos të lejonë hyrjen e tyre.
- 5.4 Internet-kafenetë janë të obliguara që të ndalojnë hapjen e Web-faqeve të cilat ndikojnë negativisht në formimin e personalitetit dhe edukimit të fëmijëve.

- 5.5 Botuesit dhe shitësit e revistave të ndryshme, përmbajtja e të cilave është degjeneruese dhe ndikon negativisht në edukimin-arsimimin, nuk mund t'ua shesin fëmijëve nën moshën 18 vjeçare .
- 5.6 Video-klubet apo subjektet tjera që merren me shitjen e videokasetave, DVD-ve, CD-ve, përmbajtja e të cilave është degjeneruese, janë të obliguara që të mos ua shesin fëmijëve nën moshën 18 vjeçare.

Neni 6 **Dispozitat ndëshkuese dhe gjobat**

- 6.1 Me gjobë në shumë prej 200€ do të dënohet:
- a) Pronari i lokalit nëse në lokalit e tij shet ose shërben pije alkoolike apo duhan në kundërshtim me dispozitat nga neni 2 të kësaj rregulloreje;
 - b) Nëse të miturit i lejohet qëndrimi në restorant apo kafiteri etj., në kundërshtim me dispozitat e nenit 3 par. 3.1 dhe 3.2 të kësaj rregulloreje;
 - c) Nëse subjektet nga neni 3 par. 3.3 veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - d) Nëse organizuesit e shfaqjeve, manifestimeve kulturore, sportive etj, veprojnë në kundërshtim me dispozitat nga neni 3 par. 3.4 dhe 3.5 të kësaj rregulloreje.
- 6.2 Me gjobë në shumë prej 100€:
- a) Nëse subjektet nga neni 4 dhe 5, veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - b) Do të dënohet personi përgjegjës i Institucionit edukativo-arsimor, nëse brenda objektit shkollor veprohet në kundërshtim me nenin 2 pika 2.1;
 - c) Nëse vërehet se prindi, kujdestari apo person tjetër nxit dhe përfiton nga shtytja e fëmijës apo të miturit duke kërkuar lëmshë do të dënohet me gjobë, në shumë prej 100€;
- 6.3 Ndaj të miturve të cilët përdorin pije alkoolike, si masë ndëshkuese do të shqiptohet edhe dërgimi në entet edukuese – korrektuese.

Neni 7

Nëse subjektet afariste, prindërit apo kujdestari ligjor, nuk bëjnë pagesën e gjobave të shqiptuara, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, ndaj tyre do të iniciohet procedura kundërvajtëse, brenda afatit prej 8 ditësh, pranë Gjykatës Kompetente.

Neni 8

Të gjitha mjetet e arkëtuara, nga shqiptimi i masave ndëshkuese për shkeljen e dispozitave të rregullores derdhen në Buxhetin Komunal.

Neni 9
Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjeve që përmbajnë dispozita që lidhen me aspektin e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve dhe të miturve.


Neni 10

Për zbatimin e kësaj rregulloreje përgjegjës janë: Drejtoria për Inspektorat dhe policia, në bashkëpunim me Koordinatorën për të Drejtat e Fëmijëve dhe udhëheqësit e institucioneve edukativo-arsimore.

Neni 11

Kjo Rregullore hyn në fuqi, ditën e miratimit, nga Kuvendi Komunal.

U miratua në mbledhjen e Kuvendit Komunal më datën 03.11. 2006.

Kryetari i Komunës

Skënder Zogaj